

V E N D I M
Nr. 660, datë 13.12.2000

PËR SHITJE TRUALLI SELISË SË ARQIPESHKVISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 4, 5, 6 dhe 8, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, "Për shitblerjen e trojeve", me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Arqipeshkvisë Tiranë-Durrës t'i shitet një sipërfaqe trualli prej 8 500 m², që ndodhet në qytetin e Tiranës, në rrugën "Zhan d'Ark", prapa hotel "Dajtit", ku është ndërtuar kompleksi i katedrales së Shën Palit dhe selia e kësaj arqipeshkvisë, sipas sheshit dhe lejes së ndërtimit, të miratuar nga KRRT-ja e Bashkisë së Tiranës.

2. Çmimi shitjes së truallit të jetë 800 lekë për m².

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta